



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:136120
Datë: 11.01.2024
Numri i dokumentit: 05179987

C – IV. – 22 - 0184

Paditësi :

M A nga fshati B i Komunës së Podujevës e të cilin me autorizim e përfaqëson, av. G A nga Prishtina.

Kundër

E paditura :

Agjencia Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë, Rr. "Dritan Hoxha", nr.55 , Prishtinë.

Për: Palët ndërgjyqëse.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), me gjykatësin e vetëm, Agron Hoxhaj, me dt.11.01.2024, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. PRANOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, M A nga fshati B i Komunës së Podujevës e ushtruar kundër të paditurës, Agjencia Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë – Autoriteti Likuidimit (AL) dhe Vendimit, PRN173 - 0341 të dt.27.05.2015 të Autoritetit të Likuidimit (AL) të të paditurës, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë për Ndërmarrjen Shoqërore (NSh), "NewCo Grand Hotel SH.P.K" me seli në Prishtinë (në likuidim) dhe Vendimi, PRN173-0341 të dt.27.05.2013 i Autoritetit të Likuidimit (AL), **NDRYSHOHET pjesërisht dhe OBLIGOHET**, e paditura, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) - Autoriteti i Likuidimit (AL) me seli në Prishtinë, që paditësit, në emër të pagave të pa paguara, t'ia kompensoj shumën prej **1,712.98 € (një mijë e shtatë qind e dy mbëdhjet euro e nëntë dhjetë e tetë centë)** për periudhën kohore prej muajit Shkurt deri në muajin Gusht 2012 nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), "Magjistranja" me seli në Prishtinë (në likuidim) e nga totali i kërkuar në shumën prej 2,264.68 € për periudhën kohore prej muajit Dhjetor 2011 deri në muajin Janar 2012 dhe se shuma e pranuar, duhet të përmbushet në pajtim me prioritetet sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit

II. REFUZOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, M A nga fshati B i Komunës së Podujevës e ushtruar kundër të paditurës, Agjencia Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë – Autoriteti Likuidimit (AL) dhe Vendimi, PRN173 - 0341 i

dt.27.05.2015 të Autoritetit të Likuidimit (AL) të të paditurës, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë për Ndërmarrjen Shoqërore (NSh), "NewCo Grand Hotel SH.P.K" me seli në Prishtinë (në likuidim) mbi pjesën e pranuar të kërkesës së paditësit, M A nga fshati B i Komunës së Podujevës e në shumën prej 551,70 € për periudhën kohore prej muajit Dhjetor 2011 deri në muajin Janar 2012, e nga totali i kërkuar në shumën prej 2,264.68 € për periudhën kohore prej muajit Dhjetor 2011 deri në muajin Janar 2012, **VËRTETOHET pjesërisht si i drejtë dhe i bazuar në ligj**.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale:

Me dt.15.07.2015, paditësi, M A nga fshati B i Komunës së Podujevës, përmes dërgimit me postë pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovë (DhPGJSK), ka parashtruar ankesën e ushtruar kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, PRN173 - 0341 i dt.72.05.2015, e me të cilin i është refuzuar si e pavlefshme kërkesa për kompensimin e pagave të papaguara në shumën prej 2,264.68 € për periudhën kohore prej muajit Dhjetor 2011 deri në muajin Janar 2012 nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), "NewCo Grand Hotel SH.P.K" me seli në Prishtinë (në likuidim) duke u bazuar në nenin 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/034 për AKP-në, ku citon se "elementet në vijim përbejnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme për refuzimin e kërkesës apo të interesit të pretenduar të kapitalit ... kërkesa apo pretendimi, është i pas afatshme nga kufizimet kohore të aplikueshme" lidhur me nenin 608 i Ligjit të Punës së Bashkuar (1976), që parashikon se: "pagesa e shumës apo rrogës ose ndonjë kërkesë tjetër të punëtorëve që rrjedh nga marrëdhënia e punës parashkruhet për tre vjet" e duke u bazuar në faktin se kërkesa e paditëses, është e parashkruar sipas nenit 36.2 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/034 për AKP-në sepse kërkesa e paditësit, është dashur të jetë e paraqitur në gjyq apo ndonjë autoritet kompetent brenda tre vjetëve nga momenti kur NSh-ja pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, pra tre vite nga koha kur parashtruesi nuk ka përfituar nga ndërmarrja të ardhurat personale të pretenduara e në rastin në fjalë, më së voni tre vjet prej dhjetorit 2011 kur parashtruesi pretendon se lindi detyrimi si dhe se parashtruesi përgjatë kësaj periudhe kohore rezultoi në marrëdhënie pune me një subjekt tjetër privat kundrejt të cilit do të duhet të ngrinte kërkesën, gjithsesi në afat për të mos lejuar parashkrimin e më gjerësisht si në këtë Vendim të AL-së.

Pala paditëse parashtruesën e ka titulluar si "ankesë" mirëpo gjykata të njëjtën e konsideron si padi në bazë të nenit 35 par.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e cila dispozitë bënë trajtimin e barabartë të parashtrësive me të cilat bëhet "nisja e procedurave" pranë Dhomës së Posaçme, pavarësisht faktit se a quhen padi, kërkesa apo ankesa.

Paditësi në ankesë e kundërshton vendimin e ankimuar duke pohuar se nuk qëndron konstatimi se kërkesa është parashkruar, se kërkesat në bazë të nenit 371 të LMD-së parashkruhen në afatin prej pesë viteve, ndërsa natyra e kërkesës që ka të bëjë me ushqimin në bazë të nenit 373.3 të LMD-së nuk parashkruhet, se ka pohuar se në këtë ndërmarrje ai ka punuar në periudhën e cekur pavarësisht se kush ishte pronari, ndërsa AKP-ja e ka pas në menaxhim këtë ndërmarrje dhe nuk i ka kryer obligimet ndaj punëtorëve, se ai si ankues, me dt.18 mars 2015, ka paraqitur kërkesë brenda afatit ligjor tek AKP-ja dhe se me shkresën, nr.246 të dt. 07.08.2012, AKP-ja, ka njoftuar punëtorët se kërkesat për paga në mënyrë meritore do të shqyrtohen nga Autoriteti i Likuidimit në procedurën e likuidimit e me kërkesë që të miratohet në tërësi e bazuar pafia e paditëses dhe të anulohet Vendimi i AKP-së, nr.4648/2015, dhe apeluesit t'i njihet e drejta në marrjen e kompensimit të pagave mujore të pa paguara nga ana e NSh, "NewCo Grand Hotel SH.P.K" në

likuidim dhe të detyrohet e paditura që ushtruesit të ankesës, t'ia paguaj shumën prej 2,264.68 euro për pagat e pa paguara sipas kontratës së punës si dhe t'ia paguaj edhe shpenzimet gjyqësore të caktuara nga gjykata e më gjerësisht si në këtë ankesë/padi.

Padisë së tij, paditësi, ia ka bashkangjitur provat: autorizimin për përfaqësim, Vendimin, PRN173-0341 e dt.27.05.2015, kopjen e ID-së së paditësit, kontratën e punës, nr.199 të dt.03.01.2007, kontratën e punës, nr.199 të dt.03.04.2007, kopjen e njoftimit të dt.02.02.20015 të AKP-së për ndërprerjen e marrdhëbnies së punës së paditësit tek e paditura, NSh, "NewCo Grand Hotel SH.P.K" me seli në Prishtinë (në likuidim), kopjen e kërkesës së dt.20 Shkurt 2012 së punëtorëve të NSh, "NewCo Grand Hotel SH.P.K" me seli në Prishtinë të drejtuar tek AKP-ja për kompensimin e pagave, kontributeve e trustit pensional të mbetura nga NSh-ja, kopjen e Njoftimit të Shoqatës së Pavarur Sindikale të dt.26.03.2012, kopjen e vendimit të Shoqatës së Pavarur Sindikale të dt.02.04.2012, kopjen e vendimit të Shoqatës së Pavarur Sindikale të dt.24.04.2012, kopjen e Përgjigjes së AKP-së, nr.246 e dt.07.08.2012 të dhënë në kërkesën e dt.24.07.2012 e punëtorëve të NSh, "NewCo Grand Hotel SH.P.K" me seli në Prishtinë, kopjen e Vendimit, Nr.prot.87 të dt.16.03.2012 të Ministrisë së Punës dhe e Mirëqenjes Sociale në Prishtinë për miratimin e kërkesës së Shoqatës së Pavarur Sindikale për t'u regjistruar pranë organit përgjegjës të MPMS-së, kopjen e kërkesës së dt.08.10.2014 së punëtorëve të NSh-së për pagesën e pagave, kontributeve dhe pushimeve të dhunshme të mbetura borxh nga ish pronari i NSh, "NewCo Grand Hotel SH.P.K" me seli në Prishtinë, kopjen e Raportit Zyrtar, 09, Nr.164 – 2340 (07) të Trupit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës në Prishtinë, kopjen e shkresës për pagat e papaguara të punëtorëve të NSh, "NewCo Grand Hotel SH.P.K" me seli në Prishtinë për muajt 12/2011 deri me 08/2012 dhe lista e emrave të punëtorëve për kontributet e pa paguara për punëtorët nga "NewCo Grand Hotel SH.P.K" me seli në Prishtinë për muajin dhjetor.2011 e deri në muajin Gusht 2012.

Me dt.18.05.2021, e paditura AKP-ja, ka parashtruar mbrojtjen e saj në ankesën e paraqitur nga pala paditëse kundër Vendimit të AL-së, PRN173-0196 e dt.25.05.2015 e në të cilën ndër të tjera ka theksuar se me rastin e vendosjes, Autoriteti i Likuidimit, ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme janë zbatuar saktë, dhe se ankesa e parashtruar nga parashtruesi nuk ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë siç parashihet me nenin 74.2 të Ligjit nr. 04/L- 034 për AKP, duke theksuar se parashtruesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit nr. 04/L- 034 për AKP është shkelur, dhe se vendimi nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë të ligjit për AKP dhe nuk ka bazë ligjore për të shfuqizuar vendimin dhe se ankesa është e pabazuar. Më tej citon se pretendimet e parashtruesit janë të pabazuara në ligj dhe parashkruara për kërkesën PRN173-0341 dt.27.05.2015, sipas nenit 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/034 për AKP-në, parashikon se "elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë ... kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme", dhe nga nenin 608 i Ligjit të Punës së Bashkuar (1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.1999/24, parashikon që: "pagesa e shumës së pagës apo rrogës apo secilës kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës parashkruhet për tre vjet", se kërkesa e paditësit, është dashur të jetë e paraqitur në gjyq apo ndonjë autoritet kompetent brenda tre vjetëve nga momenti kur NSh-ja pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, andaj në përfundim i ka paraqitur, gjykatës, që të refuzojë ankesën si të papranueshme dhe të pabazuar dhe vërtetohet Vendimi i AL-së në pajtim me nenin 74.2 të Ligjit, nr.06/L – 086 .

Me dt.24 Maj 2021, DhPGJSK-ja, si gjykatë e shkallës së parë me aktgjykimin e saj, C – IV – 15 - 1367 të dt.24.05.2021, gjykata ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditëses dhe ka vërtetuar Vendimin e AL-së, PRN173 - 0341 i dt.27.05.2015, si të drejtë dhe të bazuar në ligj, kundër të cilit paditësi ka paraqitur ankesë për Kolegjin e Apelit të DhPGJSK-së.

Me dt.22 Korrik 2022, Kolegjit i Apelit të DhPGJSK-së, si gjykatë e shkallës së dytë, me aktvendimin e tij, AC – I – 21 - 0477 – A0001 të dt.01.07.2022, ka aprovuar si të bazuar ankesën e paditësit, ka anuluar aktgjykimin e shkallës së parë, C – IV – 15 - 1367 të dt.24.05.2021 dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim, e me konstatimet e gjetura “se kërkesa e paditësit nuk është parashkruar tërësisht pasi që sipas njoftimit të dt.02.02.20015 të AKP-së për ndërprerjen e marrdhëbnies së punës së paditësit për pagat e muajit shkurt 2012 deri në muajin Gusht 2012, kërkesa e paditësit, nuk është parashkruar, se pasitësi përmes ankesës së tij në shkallën e I-rë, ka sjell listën e punëtorëve lidhur me pagat e pa paguara, pa u vulsori dhe dhe pa u protokoluar e për më tepër i jep vetëm shumat totale të pagave të pa paguara për periudhën konkrete, se paditësi, nuk ka sjell ndonjë dëshmi tjetër që të vërtetonte lartësinë e pagës mujore e më gjerësisht si në arsyetimin e këtij aktvendimi dhe se kjo këndë, në rivendosje ka marr numrin e ri, C – IV. - 22 – 0184.

Me dt.26.01.2023, DhPGJSK-ja, si gjykatë. ka ndërmarrë veprimet sipas gjetjeve të Kolegjit të Apelit nëaktv endimin e lartëcekur të saj dhe se me Urdhrin e saj, C – IV - 22 - 0184 të dt.26.01.2023, ka urdhëruar palën paditëse që të paraqet provat tjera në të cilën i ka ndërtuar thëniet në ankesë- padi e veçmas por se paditësi, nuk është përgjigjur në këtë Urdhër derisa me Urdhrin tjetër të saj, C – IV. – 22 – 0184 të dt.03.11.2023, ka urdhëruar të paditurën që të paraqet/dorëzoj sqarim me shkrim rreth çështjes së lartësisë së pagës së paditësit që e ka pasur tek NSh, ”NewCo Grand Hotel SH.P.K” me seli në Prishtinë .

Me dt.14.11.2023, e paditura duke iu përgjigjur në Urdhërin e lartëcekur të DhPGJHJK-së, kësaj gjykate ia ka sjellur kopjet e kontratrave gjegjëse të punës si atë nr.199 të dt.01.01.2015, kontratën e punës, nr.199 të dt.03.01.2007, Nr.199 të dt.03.07.2007, Nr.199 të dt.02.09.2009 dhe kontratën, Nr.1990 të dt.02.06.2010 e nga të cilat provohet se paditësi pagën mujore tek kjo NSh, e ka pasur në shumat gjegjëse mujore prej 200,00 €, 190,00 €, dhe 220.00 € dhe në shumën prej 250.00 €.

Arsyetimi ligjor:

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par. 1 pika 1 të Ligjit Nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, lidhur me nenin 398 të Ligjit të Procedurës Kontesimore, gjykata vlerëson se faktet dhe provat që i përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe gjykata merr aktgjykim, pa caktuar seancës dëgjimore.

Po ashtu në nenin 76 paragrafi 3 i Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK), parashihet se: *“Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore”* derisa sipas nenit 7 par. 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashihet se : *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*.

Pas shqyrtimit të provave të lëndës parashtrimeve dhe pretendimeve të palëve në procedurë, si dhe duke vepruar sipas vërejtjeve të bëra nga Kolegji i Apelit i DhPGJSK-së në aktvendimin e

saj, AC – I – 21 - 0477 – A0001 të dt.01.07.2022, gjykata ka ardhur në përfundimin se megjithatë kërkesëpadia e paditësit, Agron Raqi nga Prishtina, është pjerësisht e bazuar për një pjesë të saj kurse pjesërisht është e pabazuar për një pjesë të saj .

Pranueshmëria dhe afatshmëria e kërkesës së paditëses.

Gjykata, ka shqyrtuar provat të cilat i kanë ofruar palët ndërgjyqës, dhe ka konstatuar, se NSh PRN173-0341 dt.27.05.2015 në Prishtinë, ky hyrë në procedurën e likuidimit, me dt.02.02.2015, derisa pala paditëse pranë Autoritetit të Likuidimit (AL), me dt.18.03.2015, pra brenda afatit ligjor, ka parashtruar kërkesë për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën 14.02.2007 -11.05.2010, në shumë prej 580.75 €, nga NSH “NewCo Grand Hotel SH.P.K” me seli në Prishtinë (në likuidim) dhe se Autoriteti i Likuidimit (AL), pasi që ka bërë vlerësimin e kërkesës së parashtruar nga paditësi dhe se me Vendimin e tij, PRN173-0341 të dt.27.05.2015, kërkesën në fjalë të paditësit, ia ka refuzuar si e pa vlefshme derisa paditësi, pas pranimit të këtij aktvendimi në procedurën e likuidimit pas dt.26.05.2015, ankesën kundër Vendimit, PRN173-0341 të dt.27.05.2015 të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë së Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, pranë DhGJSK-së, e ka paraqitur përmes dërgimit me postë me dt.26.06.2015, pra brenda afatit ligjor prej 30 ditëve dhe se një kopje të këtij vendimi, ia ka bashkangjitur, padisë/ ankesës së saj.

Gjykata, vlerëson se padia/ankesa e paditëses, i plotëson kriteret e pranueshmërisë dhe afatshmërisë nga dispozitat e nenit 36 dhe nenit 74 Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) lidhur me nenin 37 par.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në.

Faktet kontestuese dhe jo kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse.

Gjykata vlerëson se në mes palëve ndërgjyqëse, nuk është kontestuese se paditësja me të paditurën, NSh “NewCo Grand Hotel SH.P.K” me seli në Prishtinë (në likuidim), kanë pasur raport të marrëdhënies së punës por kontestuese mbetet çështja e bazës ligjore lidhur në numrin e pagave të kërkuara, për të cilën paditësi pretendon se ka të drejtë që të kërkojë nga e paditura, NSh “NewCo Grand Hotel SH.P.K” me seli në Prishtinë (në likuidim), për kompensimin e pagave të pa paguara në shumën .2,264.68 € e për periudhën kohore prej muajit Dhjetor 2011 deri në muajin Janar 2012 nga NSH “NewCo Grand Hotel SH.P.K” me seli në Prishtinë (në likuidim), dhe se kërkesa e paditësit për kompensimin e këtyre pagave, është parashtruar apo jo.

Në nenin 6 të Ligjit Nr.04/L – 034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), që flet për fushëveprimin e kompetencave administrative të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), aty thuhet se:”Agjencia ka kompetenca të gjëra dhe ekskluzive administrative mbi të gjitha ndërmarrjet, asetet, interesat, aksionet dhe pronën që bie në fushëveprimin e nenit 5.1 dhe 5.2.”. Në rastin konkret, gjykata ka konstatuar se kërkesa e paditëses, ka të bëjë me kërkesat e pa siguruara për pagat e të parapara në nenin 40 par.1 pika 1.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) e në të cilin, parashihet se : ”Në procedurat e likuidimit të gjitha kërkesat e kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 më poshtë dhe sipas renditjes në vijim: ... kërkesat e pa siguruara, përfshirë kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë”.

Me nenin 76 paragrafi 3 i Ligjit Nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, parashihet se: “Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën

Kontestimore” derisa sipas nenit 7 par.1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashihet se : “Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”.

Gjykata për rastin në fjalë merr për bazë muajin dhjetor të vitit 2011, si datë e fillimit të rrjedhjes së afatit të parashkrimit për pagën e për të pa realizuar kur parashtruesi i ankesës/padisë, nuk ka përfituar të ardhurat personale të pretenduara nga NSh “NewCo Grand Hotel SH.P.K” me seli në Prishtinë (në likuidim), si e paditur dhe se në bazë të dispozitave së mësipërme ligjore, kërkesa nga ana e paditësit, do të duhej të parashtrohej pranë ndonjë gjykate apo autoriteti kompetent brenda 3 (tre) vjetëve nga momenti kur parashtruesi - paditësi, e kishte fituar të drejtën për të dorëzuar kërkesën për kompensim për pagat e papaguara, pra duke filluar nga muaji Dhjetor i vitit 2011 dhe se sipas vlerësimit të gjykate, dhe të një përlllogaritjeje, kërkesa e parashtruesit të ankesës - padisë lidhur me kompensimin e pagave të pa paguara, paditësit, pjesërisht i është parashkruar dhe atë në shumën prej 551,70 € për periudhën kohore prej muajit Dhjetor 2011 deri në muajin Janar 2012 (Dhjetor 2011, në shumën prej 275,85 €, dhe Janar, 2012, në shumën prej 275,85 €, pra $275,85 € + 275,85 € = 551,70 €$) derisa për periudhën kohore prej muajit Shkurt deri në muajin Gusht 2012, pjesa e kërkesës së paditësit në shumën prej 1,712.98 € (Shkurt, 2012, në shumën prej 275,85 €, muaji Mars, 2012, në shumën prej 275,85 €, 2012, muaji Prill, 2012, në shumën prej 275,85 €, muaji Maj, 2012, në shumën prej 275,85 €, muaji Qershor, 2012, në shumën prej 268,47 €, muaji Korrik, 2012, në shumën prej 250,00 €, dhe për 6 (gjashtë) ditë të muajit Gusht, 2012, në shumën prej 250,00 €, pra $4 \times 275,85 = 1,103.40 €$, $268,47 € + 250,00 € + 250,00 € = 768,47 €$, $1,103.40 € + 768,47 € = 1,712.98 €$), paditësit, nuk i është e parashkruar pra që pjesën e pa parashkruar, t’a kërkon nga e paditura, Ndërmarrja Shoqërore (NSh), "Magjistralia" me seli në Prishtinë (në likuidim) sepse kopjen e njoftimit të dt.02.02.20015 të AKP-së për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit tek e paditura, NSh-ja në fjalë, e ka pranuar me dt.02.02.2015 dhe se paditësi me pranimin e këtij njoftimi, e ka ndërprerë afatin për parashkrimin për një pjesë të kërkesëpadisë së tij derisa me bërjen e kërkesës me dt.18.mars 2015, në procedurën e likuidimit, këtë kërkesë e ka bërë brenda afatit për dorëzimin e kërkesave pranë AL-së, dhe se në rastin konkret, pra me veprimin administrativ të ndërmarr nga parashtruesi gjatë procedurës së likuidimit para AL-së, një pjesë e kërkesës së paditësit, është parashkruar kurse pjesa tjetër e kërkesës, nuk i është parashkruar sepse nuk kanë kaluar 3 (tre) vite nga lindja e detyrimit, andaj AL-ja, vetëm pjesërisht me të drejtë e ka refuzuar si të pa vlefshme një pjesë të kërkesës së tij e në shumën e prej 551,70 € e për periudhën kohore prej muajit Dhjetor 2011 deri në muajin Janar 2012 kurse pjesërisht nuk ka vepruar drejtë kur e ka refuzuar pjesën e kërkesës së paditësit, për periudhën kohore prej muajit Shkurt deri në muajin Gusht 2012 e në shumën prej 1,712.98 € për kompensimin e pagave të pa paguara. Mirëpo gjykata ka konstatuar se sipas provës - shkresës për pagat e papaguara të punëtorëve të NSh, "NewCo Grand Hotel SH.P.K" me seli në Prishtinë për muajt 12/2011 deri me 08/2012, për paditësin, pagat e pa paguara, kanë qenë në shumën prej 2,058.80 €.

Në nenin 369 të LMD-së, nr., flitet për ndërprerjen e parashkrimit, ku është përcaktuar se: *“Parashkrimi ndërpritet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”.* Pra, me pranimin e njoftimit të dt.02.02.20015 të AKP-së për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit tek e paditura, NSh-ja në fjalë, e ka ndërprerë afatin për parashkrimin për një pjesë të kërkesëpadisë së tij si dhe me paraqitjen e kërkesës kreditore nga paditësja, pranë AL-së, si autoritet kompetent për shqyrtimin e saj, është ndërprerë afati i parashkrimit në tërësi të detyrimit në të holla në emër të pagave të pa paguara derisa për një pjesë të detyrimit në të holla, paditësit i është parashkruar një pjesë e kërkesëpadisë së tij sepse i njëjti, para dt.18. Mars 2015, nuk ka prova se i është drejtuar gjykatës apo ndonjë autoritet kompetent brenda tre vjetëve nga momenti kur NSh-ja pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, pra tre vite nga koha kur

parashtruesi nuk ka përfituar nga ndërmarrja të ardhurat personale të pretenduara e në rastin në fjalë, më së voni tre vjet prej dhjetorit 2011, kur parashtruesi, këtu paditësi pretendon se lindi detyrimi.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet dhe provat të cilat i kanë ofruar palët ndërgjyqëse si dhe respektimit të qëndrimeve të Kolegjit të Apelit të kësaj gjykate të dhëna në aktvendimine tij, AC – I – 21 - 0477 – A0001 të dt.01.07.2022, kur kjo gjykatë si gjykatë e shkallës së parë, nga paditësit, ka kërkuar plotësimin e padisë së paditësit me provat gjegjëse por se i njëjti, nuk i është përgjigjur urdhrin të gjykatës derisa nga e paditura, është kërkuar që të jap sqarime gjegjëse lidhur me çështjen e lartësisë së pagës së paditësit që e ka pasur tek NSh, "NewCo Grand Hotel SH.P.K" me seli në Prishtinë dhe se e paditira, është përgjigjur dhe me përgjigjn e saj, për gjykatën ka siguruar kopjet e kontratrave gjegjëse të punës si atë nr.199 të dt.01.01.2015, kontratën e punës, nr.199 të dt.03.01.2007, nr.199 të dt.03.07.2007, nr.199 të dt.02.09.2009 dhe kontratën, nr.1990 të dt.02.06.2010 e nga të cilat provohet se paditësi pagën mujore tek kjo NSh, e ka pasur në shumat gjegjëse mujore prej 200,00 €, 190,00 €, dhe 220.00 € dhe në shumën prej 250.00 € kurse sipas listës së emrave të punëtorëve për kontributet e pa paguara nga "NewCo Grand Hotel SH.P.K" me seli në Prishtinë për muajin dhjetor.2011 e deri në muajin Gusht 2012, paditësi, në muajin Dhjetor, 2011, në muajt, Janar, Shkurt, Mars, Pril dhe Maj 2012, ka pasur pagë mujore në shumën prej 275,85 €, kurse në muajin Qershor të vitit 2012 , ka pasur pagë mujore në shumën prej 268,47 €, në muajin, Korrik dhe Gusht 2012, në shumën prej 250.00 €.

Gjykata tani nuk mund të marrë si të drejtë dhe të plotë qëndrimin juridik të të paditurës me rastin e refuzimit e pavlefshëm të kërkesës së parashtruesit, këtu paditësit në shumën prej 2,264.68 € për kompensimin e pagave të pa paguara, pasi që AL-ja, gabimisht ka zbatuar dispozitën materiale nga neni 36 par.2.2 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në dhe nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.1999/24, kur ka thënë se kërkesa e pasitësit, është e parashkruar, andaj gjykata e pranoj pjesërisht kërkesën e paditësit dhe Vendimin e AL-së, PRN173-0341 të dt.27.05.2013, e ndryshoj pjesërisht për detyrimin kryesor në të holla për periudhën kohore prej muajit Shkurt deri në muajin Gusht 2012 e në shumën prej 1,930,95 € për kompensimin e pagave të pa paguara si dhe derisa për pjesën tjetër të kërkesës së paditësit e në shumën prej 333,73 € e për periudhën kohore prej muajit Dhjetor 2011 deri në muajin Janar 2012, e ka refuzuar pjesërisht si të pa bazuar.

Sipas Letër Pezullimit të dt.02.02.2015, është provuar se paditësit, me dt.02.02.2015, i është përfunduar punësimi tek NSh-ja në fjalë pra konstatohet se paditësi kishte qenë në marrëdhënie pune tek NSh "Magjistranja" me seli në Prishtinë deri në pranimin e njoftimit të dt.02.02.2015, të lëshuar nga AKP-ja, me të cilën e njofton paditësin se marrëdhënia e punës së tij përfundon menjëherë, dhe se me këtë njoftim është bërë ndërprerja e afatit të parashkrimit të një pjese të kërkesës së paditësit për pagat e papaguara dhe se sipas listës së emrave të punëtorëve për kontributet e pa paguara nga "NewCo Grand Hotel SH.P.K" me seli në Prishtinë për muajin Dhjetor.2011 e deri në muajin Gusht 2012, paditësi, në muajin Dhjetor, 2011, në muajt, Janar, Shkurt, Mars, Pril dhe Maj 2012, ka pasur pagë mujore në shumën prej 275,85 €, kurse në muajin Qershor të vitit 2012 , ka pasur pagë mujore në shumën prej 268,47 €, në muajin, Korrik dhe Gusht 2012, në shumën prej 250.00 €, dhe se gjykata konsideron si të drejtë pranimin e pjesshëm kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin e pagat e papaguara e në shumën e lartëcekur dhe se ky qëndrim i kësaj gjykate bazohet në dispozitat nga neni 40.1.7 i Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në që në mënyrë taksative citon se :*"Në procedurat e likuidimit të gjitha kërkesat e kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 më poshtë dhe sipas renditjes në vijim: ... kërkesat e pa siguruara, përfshirë Kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë dhe se këto kërkesa dhe interesa të kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 nga i njëjti nen 40 të këtij Ligji"*.

Për çështjen e pagesës së pagave të një punësuari në një ndërmarrje në nenin 14 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.2001/27 i dt.8 tetor 2001 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë (si ligj në fuqi në kohën e ofrimit të shërbimeve të punës), ka qenë e paraparë se : *“Pagat - rrogat paguhen: (a) të paktën çdo muaj; (b) punonjësit personalisht ose përmes transferit bankar dhe (c) të shoqëruara me dëftesën e pagesës”* kurse në nenin 55 par.1 të Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit), parashihet se : *“I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit ...”* kurse nenin 67 të Ligjit të Punës, Nr. 03/ L-212 të dt.1 nëntor 2010, që flet për Ndërprerjen e Kontratës së Punës sipas fuqisë ligjore, aty thuhet se : *“Kontrata e Punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet: ... 1.8. me falimentimin dhe likuidimin e ndërmarrjes”* ndërsa në nenin 55 par.1 të Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit), parashihet se : *“I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit ...”* .

Derisa kjo gjykatë lidhur me pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë së paditësit në shumën e prej 333,73 € e për periudhën kohore prej muajit Dhjetor 2011 deri në muajin Janar 2012, vlerësoj se në rastin konkret, janë plotësuar kushtet nga neni duhet të zbatohet dispozita e nenit 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/034 për AKP-në, dhe i cili parashikon se : *“elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë ... kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”* si dhe të nenit 608 i Ligjit të Punës së Bashkuar (1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.1999/24, i cili parashikon që: *“pagesa e shumës së pagës apo rrogës apo secilës kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës parashkruhet për tre vjet”* sepse kërkesa e paditësit, është dashur të jetë e paraqitur në gjyq apo ndonjë autoritet kompetent brenda tre vjetëve nga momenti kur NSh-ja pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, andaj kjo gjykatë duke u bazuar në gjendjen e shkresave të lëndës si dhe në dispozitave ligjore të cituara, e pranoj pjesërisht kërkesën e paditësit dhe Vendimin e AL-së, PRN173-0341 të dt.27.05.2013, e ndryshoj pjesërisht për detyrimin kryesor në të holla për periudhën kohore prej muajit Shkurt deri në muajin Gusht 2012 e në shumën prej 1,930,95 € për kompensimin e pagave të pa paguara si dhe derisa për pjesën tjetër të kërkesës së paditësit e në shumën prej 333,73 € e për periudhën kohore prej muajit Dhjetor 2011 deri në muajin Janar 2012, për pagat e pa paguara, e ka refuzuar pjesërisht si të pa bazuar.

Vlerësimet përfundimtare të çështjes nga ana e gjykatës.

Gjykata pas shqyrtimit të të gjitha provave të cilat gjendjen në shkresat e lëndës, ka vlerësuar se pjesërisht nuk qëndron pretendimi i të paditurës, AKP-së të se kërkesa e paditësit, është e pavlefshme e mbi bazën e parashkrimit të saj e kuptim të nenit 36 par..2 pika 2 të Shtojcës së Ligjit të, Nr.04/L – 034 për AKP-në si dhe nenit 608 i Ligjit të Punës së Bashkuar (1976), kur në Vendimin e kundërshtuar të AL-së, PRN173-0341 të dt.27.05.2013, e paditura ka theksuar ka thënë se kërkesa e paditësit, është e parashkruar, andaj nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se paditësi, , kishte ofruar shërbime punë për NSh-në dhe se NSh-ja, i kishte mbetur borxh pagat e pa paguara për periudhën e lartcekur kohore dhe kësaj i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e pranuar të saj. Andaj gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko – kontestimore, kërkesëpadia e paditësit, M A nga fshati B i Komunës së Podujevës e ushtruar kundër të paditurës, AKP-së me seli në Prishtinë lidhur me Vendimin, PRN173-0341 të dt.27.05.2013 të Autoritetit të Likuidimit (AL) për Ndërmarrjen Shoqërore (NSh), “Magjistranja” me seli në Prishtinë (në likuidim), është pjesërisht e bazuar, dhe se i njëjti Vendim i AL-së, duhet të ndryshohet si dhe të detyrohet e paditura, AKP-ja me seli në Prishtinë,

që paditësit, t'ia kompensoj shumën prej 1,712.98 € për periudhën kohore prej muajit Shkurt deri në muajin Gusht 2012 nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), "Magjistranja" me seli në Prishtinë (në likuidim) e nga totali i kërkuar në shumën prej 2,264.68 € për periudhën kohore prej muajit Dhjetor 2011 deri në muajin Janar 2012 derisa Vendim i AL-së, PRN173-0341 të dt.27.05.2013 mbi pjesën e pranuar të kërkesës së paditësit, M A nga fshati B i Komunës së Podujevës e në shumën prej 551,70 € për periudhën kohore prej muajit Dhjetor 2011 deri në muajin Janar 2012, dhe pjesërisht të refuzuar të kërkesëpadisë, duhet të vërtetohet si drejtë dhe i bazuar në ligj.

Përfundimisht gjykata ka konstatuar se në rastin konkret pala kundërshtare pjesërisht drejtë ka vepruar kur ka zbatuar dispozitën ligjore të cituara me lartë dhe bazuar në vërtetimin e kësaj gjendje faktike.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 4 par.9, nenit 9, nenit 54 par.1 dhe nenit 74 par.4 të Ligjit nr. 06/L - 086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) lidhur me nenin 153, 159, 160, 190, 197 dhe nenit 199 të Ligjit, Nr.03/L -066 për Procedurën Kontestimore (LPK) .

Shpenzimet Gjyqësore

Në bazë të nenin 62 par.5 të Ligjit nr. 06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me nenin 13 par.3 dhe 13 par.9 të Udhëzimit administrativ, Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore të KGJK-së, dhe lidhur me nenin 449, 450 dhe nenin 463 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjykata vendosi që secila palë t'i bart shpenzimet e veta procedurale në këtë çështje juridike kontestimore pasi që pala paditëse, edhe pse e ka fituar procesin gjyqësor, dhe është e përfaqësuar nga avokati, i njëjti nuk i ka specifikuar shpenzimet e kërkuara procedurale në këtë çështje juridike kontestimore.

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS **2022:136120, 11.01.2024**

Gjykatësi,
Agron Hoxhaj

KËSHILLË JURIDIKE :

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme dhe atë brenda **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK).